



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 18 prill 2018
Nr. ref.: RK 1219/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI116/17

Parashtrues

Ahmet Ajeti

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Pml. nr. 213/2017, të 29 gushtit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Ahmet Ajeti (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i cili gjendet në paraburgim në Qendrën për Siguri të Lartë, në Gërdovc, të komunës së Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 213/2017, i 29 gushtit 2017 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda (NJN. nr. 1/2016, i 16 majit 2017) dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit (Pn. nr. 502/17, i 30 qershorit 2017).
3. Parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar më 11 shtator 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtëpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], paragrafin 3, të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimi Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], paragrafin 4, të nenit 35 [Liria e lëvizjes], paragrafin 1, të nenit 40 [Liria e Shprehjes], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dispozitave të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe të nenit 14 të Paktit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave Civile dhe Politike (në tekstin e mëtejme: Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 28 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 3 tetor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 7 dhjetor 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoj plotësimin e formularit të kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

9. Më 8 dhjetor 2017, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës edhe Ministrisë së Drejtësisë dhe e ftoi që, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimi të shkresës, të dorëzojë komentet e saj eventuale përkitazi me kërkesën.
10. Më 11 dhjetor 2017, Gjykata pranoi komentet e Ministrisë së Drejtësisë.
11. Më 4 janar 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës të plotësuar dhe të nënshkruar.
12. Më 1 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi informata shtesë.
13. Më 1 mars 2018, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

14. Më 16 janar 2012, Gjykata për Krime të Rënda në Tiranë, në Republikën e Shqipërisë, shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprave penale vrasje me paramendim të kryer në bashkëpunim e cila ka mbetur në tentativë dhe armëmbajtje pa leje, dhe e dënoi atë me 21 (njëzet e një) vite burgim. Gjykimi kundër parashtruesit të kërkesës ishte zhvilluar në mungesë të tij.
15. Më 7 mars 2016, autoritetet e Republikës së Shqipërisë kishin lëshuar urdhërarrest ndërkombëtar për arrestimin e parashtruesit me qëllim të ekstradimit të tij në Republikën e Shqipërisë.
16. Më 14 mars 2016, parashtruesi i kërkesës ishte arrestuar nga autoritetet policore të Republikës së Kosovës.

Procedurat përkitazi me paraburgimin e parashtruesit të kërkesës

17. Më 15 mars 2016, gjyqtari i procedurës paraprake në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: gjyqtari i procedurës paraprake) përmes Aktvendimit (NJND. nr. 1/2016) ndaj parashtruesit të kërkesës caktoi paraburgimin në kohëzgjatje prej 40 (dyzet) ditësh.
18. Kundër aktvendimit të lartcekur të gjyqtarit të procedurës paraprake, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
19. Më 21 mars 2016, Gjykata e Apelit (Aktvendimi PN1. nr. 469/2016) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.
20. Më 21 prill 2016, gjyqtari i procedurës paraprake (Aktvendimi NJND. nr. 1/2016) vazhdoi paraburgimin ndaj parashtruesit të kërkesës deri në përfundimin e procedurës së ekstradimit të parashtruesit.

21. Kundër aktvendimit të lartcekur të gjyqtarit të procedurës paraprake (NJND. nr. 1/2016, të 21 prillit 2016), parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
22. Më 28 prill 2016, Gjykata e Apelit (Aktvendimi PN1. nr. 469/2016) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

Procedurat në lidhje me kërkesën për ekstradim të parashtruesit

23. Më 29 mars 2016, Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë përmes Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës parashtroi kërkesën për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës në Republikën e Shqipërisë.
24. Më 21 shtator 2016, Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Prokurori i Shtetit), bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik në Çështje Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik) dhe Marrëveshjes Dypalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë mbi Ekstradimin të 6 nëntorit 2012 (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja Dypalëshe) parashtroi kërkesën (NJN. nr. 19/2016) në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës në Republikën e Shqipërisë.
25. Më 16 maj 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit (NJN. nr. 1/16) lejoi ekstradimin e parashtruesit të kërkesës në Republikën e Shqipërisë.
26. Gjykata Themelore në aktvendimin e saj deklaroi se bazuar në dispozitat e Ligjit të lartcekur për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar dhe Marrëveshjes Dypalëshe mbi Ekstradimin, më 18 janar 2017 përmes Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë kishte kërkuar *“garancione që i kërkuari për ekstradim [parashtruesi] ka të drejtën e rigjyimit ose rishikimit të vendimit të dhënë ndaj tij [...]”*.
27. Gjykata Themelore më tej deklaroi se Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë përmes shkresës së saj kishte *“dhënë garancion se të kërkuarit [parashtruesit] do t’i respektohet e drejta për rigjykim, dhe se i njëjti me aktin e ekstradimit do ta ketë një rigjykim në shtetin e Shqipërisë.”*
28. Si rrjedhojë, Gjykata Themelore konsideroi se ishin plotësuar kushtet ligjore për lejimin e ekstradimit të parashtruesit të kërkesës në Republikën e Shqipërisë.
29. Kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës me pretendimin për shkelje të dispozitave të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.

30. Më 30 qershor 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit (PN. nr. 502/2017) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit.
31. Gjykata e Apelit konstatoi se Aktvendimi i Gjykatës Themelore për lejimin e ekstradimit ishte i drejtë për arsye se ishin plotësuar të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar për ekstradimin e parashtruesit në Republikën e Shqipërisë.
32. Në aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit konstatoi se *“Për arsyet e lartcekura, kjo Gjykatë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka lejuar ekstradimin e personit tani të kërkuar, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara nga neni 6,8,9,10,11,12,13,14,15,16 dhe të ligjit Nr. 04/L-213, Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, për lejimin e ekstradimit të [parashtruesit të kërkesës]”*.
33. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore (NJN. nr. 1/16) dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit (PN. nr. 502/2017) për shkak të shkeljes së nenit 35, paragrafi 4, të Kushtetutës dhe nenit 13 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik, si dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike.
34. Parashtruesi i kërkesës më tej pohon se nuk ka qenë në dijeni lidhur me zhvillimin e procedurës penale kundër tij në Republikën e Shqipërisë, si dhe sipas tij autoritetet e Republikës së Shqipërisë *“nuk kanë dhënë garancione të nevojshme dhe të besueshme”* për rigjykim në rast të ekstradimit të tij në Republikën e Shqipërisë.
35. Më 29 gusht 2017, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit (Pml. nr. 2132/2017) refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë.
36. Gjykata Supreme, në aktgjykimin e saj vlerëson se *“pretendim[i] se Republika e Shqipërisë nuk ka dhënë garancione [të] nevojshme dhe të besueshme se do të garantohet e drejta në rigjykim, ky pretendim nuk qëndron sepse Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë ka dërguar garancionin që të gjykuarit t’ia mundësojnë të drejtën për rigjykim dhe të drejtën për rivendosje në afat të ankimimit, si dhe angazhohet se do t’i akordojë personit të kërkuar garancitë procedurale të njohura nga Pakti Ndërkombëtar i 16 dhjetorit 1966 në lidhje me të drejtat civile dhe politike (Pakti i OKB II), si dhe nga Konventat Europiane për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut.”*
37. Gjykata Supreme konkludoi se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të Kushtetutës dhe të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik, dhe se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit *“kanë bërë vlerësimin e pretendimeve [të parashtruesit] dhe kanë dhënë arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsye të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë.”*
38. Në një datë të pasaktësuar, mbështetur në vendimet e gjykatave të rregullta dhe garancionet e ofruara nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë, Ministri i Drejtësisë i Republikës së Kosovës nxori Vendimin për lejimin e ekstradimit të

parashtruesit të kërkesës në Republikën e Shqipërisë. Sipas njoftimit të Ministrisë së Drejtësisë, parashtruesi ishte udhëzuar se kundër Vendimit të Ministrit të Drejtësisë mund të iniciojë konflikt administrativ.

39. Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, në letrën e saj drejtuar Gjykatës, njoftoi si vijon:

“Përmes shkresës së datës 18 janarit 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Ministrisë së Drejtësisë ka kërkuar garancione nga autoritetet e Shqipërisë, se ndaj tij do të mundësohet e drejta në rigjykim ose në rishikimin e vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij, sipas nenit 11 të Marrëveshjes mbi Ekstradimin të lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Si përgjigje ndaj kësaj kërke, nga Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë, më 13 shkurt 2017, kemi pranuar një shkresë përmes së cilës garantohej respektimi i të drejtës për rigjykim, në bazë të nenit 51 të Ligjit Nr. 10193 për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale si dhe në bazë të neneve 147, 148, 449, 450, 453 të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë, përmes rivendosjes së afatit për ankimin apo rishikim të vendimit. Po ashtu Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë garanton se personit të ekstraduar do t'i ofrohen garancitë procedurale të përcaktuara nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i datës 16 dhjetor 1966, si dhe nga Konventat Evropiane për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.”

40. Ministria e Drejtësisë, në fund informon se *“Duke u bazuar në vendimet e Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe atë të Gjykatës së Apelit si dhe në garancionet e ofruara nga Ministri i Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 30.1 dhe 3 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik në Çështjet Penale, Ministria e Drejtësisë ka marrë vendim për të lejuar ekstradimin e z. Ajeti në Republikën e Shqipërisë. Ky vendim është dërguar edhe te personi, subjekt i ekstradimit, njëkohësisht duke udhëzuar se ndaj të njëjtit vendim mund të fillohet konflikt administrativ, në përputhje me Ligjin për Konfliktet Administrative.”*
41. Në kërkesën e plotësuar të dorëzuar më 4 janar 2018, parashtruesi i kërkesës pretendon se atij nuk i ishte dorëzuar ky vendim dhe, ai nuk ka dorëzuar dokumente që dëshmojnë se ka ndërmarrë veprime të mëtejme procedurale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], paragrafin 3, të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimi Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], paragrafin 4, të nenit 35 [Liria e Lëvizjes], paragrafin 1, të nenit 40 [Liria e Shprehjes], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.

43. Parashtruesi i kërkesës vetëm ka përmendur dispozitat dhe të drejtat e lartpërmendura të garantuara me Kushtetutë, por nuk ka sqaruar apo mbështetur se si këto të drejta të garantuara me Kushtetutë janë shkelur në rastin e tij.
44. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon shkelje të dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Në lidhje me këtë, parashtruesi nuk ka saktësuar se cilat të drejta të garantuara me KEDNJ i janë shkelur.
45. Parashtruesi në kërkesën e tij, pretendon se në rast të ekstradimit të tij në Republikën e Shqipërisë nuk ka garanci të mjaftueshme dhe të besueshme se atij do t'i lejohet ose mundësohet rigjykimi.
46. Parashtruesi po ashtu pretendon shkelje të dispozitave të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik, në veçanti nenet 13 dhe 17. Në lidhje me këtë, parashtruesi pohon se ai nuk mund të ekstradohet pasi që në rastin e tij ka një vendim të formës së prerë, me të cilin është dënuar.

Pranueshmëria e kërkesës

47. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe më tej të parapara në Ligj dhe të përcaktuara në Rregullore të punës.
48. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

49. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi e ka përmbushur kriterin për dorëzimin e kërkesës së tij në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

50. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 213/2017, të 29 gushtit 2017, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, ka dorëzuar kërkesën e tij në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

51. Megjithatë, Gjykata më tej duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret e parapara me nenin 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit dhe me rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Rregulli 36
[Kriteret e pranueshmërisë]

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

52. Fillimisht, Gjykata rikujton se parashtruesi shprehimisht konteston vendimet e gjykatave të rregullta, përmes të cilave është konstatuar se janë përmbushur të gjitha kriteret ligjore për ekstradimin e parashtruesit në Republikën e Shqipërisë. Vendimi përfundimtar në lidhje me këtë procedurë është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 213/2017, të 29 gushtit 2017. Prandaj, marrë për bazë edhe pretendimet e ngritura të parashtruesit në kërkesën e tij, Gjykata konsideron se objekt i çështjes së vlerësimit nga Gjykata është aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme.

53. Gjykata rikujton se parashtruesi në kërkesën e tij ka pretenduar shkelje të neneve 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtëpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimi Mizer, Çnjerëzor ose Poshtëruar], 35 [Liria e Lëvizjes], 40 [Liria e Shprehjes], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.

54. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm ka përmendur dispozitat dhe të drejtat e lartpërmendura të garantuara me Kushtetutë, por nuk ka sqaruar apo mbështetur se si këto të drejta të garantuara me Kushtetutë janë shkelur në rastin e tij.
55. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon po ashtu shkelje të nenit 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe dispozitave të KEDNJ-së. Parashtruesi nuk saktëson se cilat të drejta të garantuara me KEDNJ i janë shkelur.
56. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij, në thelb, pretendon se në rast të ekstradimit të tij në Republikën e Shqipërisë, autoritetet e Shqipërisë nuk kanë ofruar garanci të mjaftueshme se atij do t'i lejohet apo mundësohet rigjykimi i rastit të tij.
57. Gjykata i referohet paragrafit 4, të nenit 35 [Liria e Lëvizjes] të Kushtetutës, që përcakton:

[...]

“4. Shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen nga Kosova kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe”.

[...]

58. Gjykata rikujton që kërkesa për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës në Republikën e Shqipërisë bazohet në Marrëveshjen Bilaterale mbi Ekstradim midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.
59. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 19 të Kushtetutës i cili parasheh që *“Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji”.*
60. Gjykata gjithashtu përkujton nenin 11 [Gjykimet në mungesë] të Marrëveshjes Bilaterale të lartpërmendur, e cila përcakton që *“ekstradimi lejohet, në qoftë se pala kërkuese jep garanci se i ekstraduari, nëse është gjykuar në mungesë, ka të drejtën e rigjyimit ose rishikimit të vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij”.*
61. Përveç kësaj, neni 17 [Klauzola jodiskriminuese dhe standardet e të drejtave të njeriut] të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar po ashtu thekson se *“Ekstradimi i kërkuar me qëllim të ekzekutimit të dënimit të shqiptuar me aktgjykim të dhënë në mungesë, lejohet vetëm nëse gjatë procedurës së zhvilluar kundër personit janë respektuar të drejtat minimale të mbrojtjes, të njohura për çdo person të akuzuar për kryerjen e një vepre penale. Ekstradimi mund të lejohet nëse shteti kërkuës ofron garanci të mjaftueshme*

për të siguruar që personi i kërkuar ka të drejtën për rigjykim me qëllim që të sigurohen të drejtat minimale të mbrojtjes”.

62. Në rastin e parashtruesit, Gjykata vëren se Gjykata Themelore, në aktvendimin e saj, pas pranimit të shkresës së Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, përmes të cilës ofrohen garancitë se ndaj parashtruesit do të respektohet e drejta për rigjykim *“përmes rivendosjes së afatit për ankimin apo rishikim të vendimit”* ka konstatuar se të gjitha kushtet ligjore për lejimin e ekstradimit të parashtruesit në Republikën e Shqipërisë ishin përmbushur. Për më tepër, Gjykata e Apelit gjithashtu konstatoi se Aktvendimi i Gjykatës Themelore për lejimin e ekstradimit të parashtruesit në Republikën e Shqipërisë ishte i drejtë, sepse ishin përmbushur të gjitha kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.
63. Ndërsa, sa i përket vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesit si të pabazuar, duke konstatuar se nuk kishte shkelje të nenit 35, paragrafit 4, të Kushtetutës dhe dispozitave të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik, duke konstatuar që *“[...] si gjykata e shkallës së parë po ashtu edhe dhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin e pretendimeve dhe kanë dhënë arsyetimin e duhur dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat janë si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë”.*
64. Gjykat rikujton më tej se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme konstatoi:

“Bazuar në dispozitën e nenit 11 të Ligjit nr. 2/2013 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Ekstradim, par.1 theksohet “ekstradimi lejohet, në qoftë se pala kërkuese jep garanci se i ekstraduari, nëse është gjykuar në mungesë, ka të drejtën e rigjyimit ose rishikimit të vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij”. Ndërsa sa i përket pretendimit se Republika e Shqipërisë nuk ka dhënë garancione të nevojshme dhe të besueshme se do të garantohet e drejta në rigjykim, ky pretendim nuk qëndron sepse Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë ka dërguar garancionin që të gjykuarit t’ia mundësojë të drejtën për rigjykim dhe të drejtën për rivendosje në afat të ankimit, si dhe angazhohet se do t’i akordojë personit t[ë] kërkuar garancionet procedurale të njohura nga Pakti Ndërkombëtar i 16 dhjetorit 1966 në lidhje me të drejtat civile e politike [...] si dhe nga Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut”.

65. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Gjykata vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në jurisdiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave

të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

66. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se autoritetet e Republikës së Shqipërisë, gjithashtu kanë siguruar se parashtruesit të kërkesës “do t'i ofrohen garanci procedurale të përcaktuara me Paktin Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike dhe nga KEDNJ, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë”.
67. Gjykata në këtë rast i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), e cila në parim ka theksuar se “[...] Gjykata vëren se e drejta për gjykim të drejtë në procedurën penale, siç mishërohet në nenin 6, gëzon një vend të veçantë në një shoqëri demokratike, dhe Gjykata nuk e përjashton mundësinë që një çështje përjashtimisht mund të ngritet sipas nenit 6 nga një vendim ekstradimi në rrethanat ku i arratisuri ka vuajtur ose rrezikon të vuajë një mohim flagrant të një gjykimi të drejtë në vendin kërkuar (shih rastet *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, [DHM], Kërkesa nr. 14038/88, Aktgjykimi i 7 korrikut 1989, paragrafi 113, dhe *Mamatkulov dhe Askarov kundër Turqisë* [DHM], Kërkesat numër 46827/99 dhe 46951/99, paragrafi 88).
68. Për më tepër, GJEDNJ ka theksuar se kur një parashtrues përballlet me ekstradimin në një shtet tjetër, i cili është palë kontraktuese në Konventë, supozimi është se personi do të ketë një gjykim të drejtë, marrë në veçanti për bazë ekzistencën e mjeteve juridike kundër çdo padrejtësie të mundshme në atë vend, duke përfshirë edhe parashtrimin eventual të një kërkesë në GJEDNJ (Shih rastin *Stapleton kundër Irlandës*, Kërkesa nr 56588/07, Vendimi për pranueshmërinë i 4 majit 2010, paragrafi 26).
69. Në vijim, Gjykata, po ashtu, vë në dukje se fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta, si dhe vetëm të përmendurit e neneve përkatëse të Kushtetutës pa shtjelluar shkeljen e pretenduar të tyre, nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim të mbështetur për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
70. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur pretendimet e tij se si procedurat e përfunduara në gjykatat e rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e vendimeve të këtyre gjykatave.
71. Nga arsyet e mësipërme, Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkelje të neneve 21, 22, 23, 24, 27, 35, 40, 53 dhe 55 të garantuara me Kushtetutë, nenit

14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur fare pretendimet e tij.

72. Prandaj, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d), kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE


Në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, në seancën e mbajtur më 1 mars 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

